

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJILAN DEGA NË VITI, Departamenti i përgjithshem penal, duke vendosur sipas gjyqtarit Skender Shefkiu me sekr. Juridike Naime Ibishi, në çështjen penale kundër të akuzuarin, E.Z nga fsh., K.Vitisë, për shkak të veprës penale Vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-ës. e sipas aktakuzës të PTHSH nga Gjilani, PP.II.nr.857/2015 të dt.05.06.2015, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor e publik më dt.30.03.2017 shpallë dhe publikoj këtë:

A K T G J Y K I M

E akuzura E. Z. nga babai Se. dhe nënës H.e vajzeris H. , e data e lindjes fsh, K.Viti dhe ku edhe jeton, ka të kryer shkollën mesme ,e pa punë, e ve, e martuar, nën e 3 femijëve, me gjendje të dobët ekonomike, shqiptarë, Shtetase e Republikës së Kosovës.

**ËSHTË FAJTORE
SEPSE**

Me datën 24.11.2014, në kohë të papercaktuar , në fsht. K.Vitisë, nga sektori i kalbrimit në Prishtinë është konstatuar se e pandehura në shtëpinë e tij, me qëllim që vetit të sjell përfitimi të kundërligjshëm pasurore, pa autorizim ka shpenzuar energjinë elektrike, në atë mënyrë që në njëhjesorin elektrikë me nr.9XXX, për rreth qelqit nga ana e djathtë e ka futur shiritin folmik ashtu që ka penguar punën normale të diskut, kurse në brendi të njëhjesorit është gjetur pluhur të shiritit folmik, me cka i njetit ka pamundesuar regjistrimin e shpenzuar të energjisë elektrike , duke dëmtuar KEDS-in diskutriti në Gjilan, në shumë prej 206.00 €.

-me çka ka kryer veprën penale Vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-ës

-Andaj Gjykata në bazë të nenit 41 51, 73, 74, e 75 të KPRK-së, dhe neni 365 të KPPRK-së,

E G J Y K O N

Denim me gjobë në shumë prej 100€ (njqindeuro) dhe denim me burg në kohezgjatje prej 90 ditëshë.

Dënimet e shqiptuara nuk do të ekzekutohen me **KUSHT që brenda 1 viti** , mos të kryej veprë tjetër penale (koha e verifikimit). Në të kundërtën dënimet e tilla do të revkohen.

I demtuari perfaqesusi i te KEDS-it, Distrikiti ne Gjilan per realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohen në kontest civil.

A r s y e t i m

PTHSH nga Gjilani, ka ngritur aktakuze me dt. 28.09.2015 me nr PP.II.nr.1618 /2015, ndaj te akuzues E.Z nga fsh. ..K.Vitise , për shkak të vepres penale Vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-ës.

PSh-re nga Gjilani, Kujtesa Fazliu në fjalën perfundimtare deklaron- Mbetem ne tersi pran aktakuzes se paraqitur dhe propozimeve qe e njejta i permban pasi qe gjendja faktike ne kete qeshtje penalo juridike u vertetua edhe me pranimin e të akuzuarit, pranim ky qe eshte ne perputhshmeri te plot edhe me provat tjera te cilat jan propozuar per tu shtjelluar si prova per ta vertetuar te drejten ne menyre te plot gjendjen faktike. Me rastin e matjes se shqiptimin te denimit ti merren parasysh te gjitha rrethanat si ato renduse po ashtu edhe ato lehtsuese ndersa ne anen tjeter edhe faktin se i pandehuri ishte korrekt para Gjykates dhe e pranoj fajesin.

E akuzuara E.Z. ne fjalën perfundimtare deklaron- ka kerkuar nga Gjykata qe t'ja shqiptoj nje denim sa me te buët, nga fakti se per vepren penale te cilen e ka kryer eshte penduar, nuk do te perserise me kete veper e as vepra te tjera penale. Jam e ve, dhe mbajtese e familjes, eshte me gjendje te veshtire ekonomike , eshte I pa pune, eshte hera e pare qe kam ra ndesh me ligjin.

Ne shqyrtimin gjyqesor e akuzuari ne tersi e pranoj fajsinë,sipas dispozitave te aktakuzes,gjykata ka qene e bindur se i njejti ka kuptuar natyren dhe pasojat e pranimit te fajsis ,se pranimi eshte bere vullnetarisht nga e akuzuara dhe pranimi i fajsis eshte mbeshtetur ne faktet qe permban aktakuza ,ne provat e prezentuara nga prokururia te cilat kane qenë te pranuar nga e akuzuara.

Duke vlersuar pranimin e fajsis se te akuzuares gjykata fare nuk i shtjelloi provat ngase gjendja faktike ne kete çeshtje penale nuk ishte kontestuese ,e akuzuara pranimin e fajsis e beri duke mos kontestuar asnje faktë nga dispozita e aktakuzes .

Pra nje gjendje te ketill faktike te pa kontestuar,gjykata e gjeti se ne veprimet e te akuzuares egzistojn te gjitha elementet qensore te vepres penale , asgjesimi apo demtimi I pasurise nga neni 333 parag.1 te KPRK-së.

Gjykata pas vlerësimit të provave që gjinden në shkresat e lëndës e pasi që e akuzuara ka pranuar ne tërsi veprën penale, pranimin e fajsis e cila është bërë në përputhje me dispozitat e nenit 246 te KPRK-ës, e qe i vihet ne barre, Gjykata u perqendrua ne vendosjen vetem perkitazi mbi matjen dhe lartësin e dënimit konform nenit 73 i KPK, dhe keshtu me rastin e caktimit te lartësisë së dënimit

Gjykata pati parasysh rrethanat lehtesuse dhe ato renduse, te cilat ndikojne ne zbutjen apo ashpërsimin e denimit.

Si rrethanë lehtësuese Gjykata pati parasysh pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuares, sjelljen korrekte ne Gjykatë, është në gjendje të vështirë ekonomike, dhe ka premtuar se te ardhmen nuk do te

kryej vepra penale të tjera. Si rrethanë rënduese Gjykata pati parasysh shkallen e përgjegjesisë, rrezikshmërin shoqërore të veprës penale dhe dëmin e shkaktuar të dëmtuareve.

Bindja e Gjykates se denimi i shqiptuar është i ligjshëm, është në propocion me veprën penale përgjegjësive penale të akuzues dhe se me denimin e tillë të shqiptuar do të arrihet qellimi nga neni 41 i KPRK-es.

Lidhur me kërkesën pasurore –juridike është vendosur konform neni 463 par.2 të KPPK-se, duke udhëzuar të dëmtuarin në tërësi në kontest civil sepse të dhanat e mbledhura në procedurën penale nuk paraqesin bazë të sigurt për një gjykim të plotë.

Vendimi mbi paushallin gjyqësor është bazuar konform neni 450 të KPPRK-së.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-DEGA NË VITI
P. nr.291/2015
Me.30.03.2017

Sek.juridike,
Naime Ibishi

Gj y q t a r i,
Skender Shefkiu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.